



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600970/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, duke zgjeruar kriteret dhe rrethin e personave përfitues, me qëllim sigurimin e një aksesit efektiv në drejtësi nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike falas edhe për viktimat e diskriminimit.*

Drejtuar : **Ministrit të Drejtësisë**
Z. Ylli MANJANI

Tiranë

Për dijeni : **Z. Fatmir XHAFA**
Kryetar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë

I nderuar zoti Manjani,

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), i themeluar nga Këshilli i Evropës, në Raportin Monitorues për Shqipërinë, botuar në Qershor 2015, drejtuar qeverisë shqiptare ka paraqitur disa rekomandime, sugjerime dhe propozime lidhur me trajtimin e problemeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e gjendjes së racizmit dhe intolerancës në Shqipëri.

Ndërmjet këtyre rekomandimeve, në paragrafin 24 të Raportit, ECRI rekomandon që *autoritetet të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për viktimat e diskriminimit nëpërmjet një sistemi të ndihmës ligjore që është funksional dhe plotësisht i financuar.*

Nga përmbajtja e dispozitave të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, dhe konkretisht në nenin 13 të tij ku parashikohen kriteret e ndihmës juridike, rezulton se nuk janë përfshirë si përfitues i kësaj të drejte ligjore viktimat e diskriminimit.

Ndërkohë nga shqyrtimi i disa rasteve të ankesave dhe kërkesave të bëra në Institucionin e Avokatit të Popullit nga persona të ndryshëm, të cilët ndonëse plotësojnë kriteret për përfitimin e ndihmës juridike, në fakt nuk e përfitojnë atë, për shkak të mungesës së fondeve dhe të mosfrimit të këtij shërbimi në të gjitha qytetet, njësitë administrative dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të vendit. Kjo situatë ka sjellë si pasojë mungesën e aksesit efektiv në drejtësi të personave që de jure janë përfitues nga ligji aktual, si dhe të personave që janë viktimë e diskriminimit të të gjitha llojeve.

Ju sjellim në vëmendje se vendi ynë, si anëtar i Këshillit të Europës, është i detyruar që të marrë në shqyrtim të gjitha raportet e këtij këshilli dhe të organizmave përbërës të tij, si dhe të zbatojë rekomandimet, propozimet dhe sugjerimet e bëra prej tyre.

Për sa më sipër dhe me qëllim zbatimin e rekomandimit të ECRI-t dhe krijimin e mundësisë për sigurimin e një aksesit efektiv në drejtësi nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike falas edhe për viktimat e të gjitha llojeve të diskriminimit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “c” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projektligjit për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, duke zgjeruar kriteret dhe rrethin e personave përfitues, me qëllim sigurimin e një aksesit efektiv në drejtësi nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike falas edhe për viktimat e të gjitha llojeve të diskriminimit.

2. Dërgimin e këtij projektligji për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvendin e Shqipërisë.

3. Rritjen e buxhetit për Shërbimin e Ndihmës Juridike me qëllim garantimin e aksesit efektiv në sistemin e drejtësisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI